



2 GUSHT 2015

MOSMARRËVESHJET LIDHUR ME PËRDORIMIN E GJUHËVE NË KOSOVËSI DHE IMPLEMENTIMI I DOBËT I KORNIZËS LIGJORE

Në takimin e Komisionit për Legjislacion të Kuvendit, mbajtur më 27 qershor ditë e hënë, kryetarja e Komisionit Albulena Haxhiu e Lëvizjes Vetëvendosje, morri vendim që të mos procedohet tutje me propozimin për ndihmë juridike të dërguar nga Ministria për Komunitete dhe Kthim deri sa të merret interpretimi nga organet administrative të Kuvendit në lidhje me përdorimin e alfabetit cirilik në propozim. Sipas Haxhiut, formati i propozimit, dhe në veçanti fakti që stema e Kuvendit ishte shkruar në alfabetin cirilik, nuk është tipike për Kuvendin e Kosovës.¹

Ministri për Komunitete dhe Kthim Dallibor Jevtiqi Listës serbe (*Lista srpska*) lëshoi një deklaratë zyrtare në të cilën ai iu referuar Ligjit për Përdorimin e Gjuhëve Zyrtare i cili thotë se gjuha shqipe dhe serbe dhe alfabetet e tyre janë gjuhë zyrtare dhe kanë status të barabartë në institucionet e Kosovës.² Duhet të theksohet se Ligji nuk e specifikon në mënyrë eksplicite se për cilat alfabetë bëhet fjalë, gjë që mund të sjell disa paqartësi kur bëhet fjalë për serbishten që përdor dy alfabetë, atë latin dhe cirilik. Shumica e ueb-faqeve zyrtare, pronë e institucioneve qeveritare dhe të operuara nga to, duke përfshirë këtu ueb-faqen e Kuvendit, përdorin alfabetin latin.³ Në letërnjoftime, megjithatë, përdoret alfabeti cirilik i gjuhës serbe.

Jevtiqi e interpretoi vendimin e Haxhiut që të mos procedohet tutje me propozimin si shkelje të të drejtave ligjore dhe njerëzore të komunitetit serb në Kosovë për përdorimin e gjuhës së vet amtare. Ai gjithashtu iu referua incidenteve tjera ku Lëvizja Vetëvendosje, sipas tij, e “poshtëroi” komunitetin serb në Kosovë. Në fund, Jevtiqi kërkoi që Haxhiu të kërkojë falje publike nga i gjithë komuniteti serb.⁴ Jasmina Zhivković, deputete e Kuvendit nga radhët e Listës serbe, propozoi që Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe për Kthim të lëshojë një deklaratë me anë të së cilës komisioni do të kërkojë sqarime dhe llogaridhënie për, siç iu referua Zhivković, vendimin e “papurueshëm” të Haxhiut me anë të së cilit Haxhiu bllokoi një dokument zyrtar në një nga gjuhët zyrtare në Kosovë.⁵

¹http://www.balkaninsight.com/en/article/cyrillic-documents-causes-confusion-in-kosovo-parliament?utm_source=Balkan+Insight+Newsletters&utm_campaign=86bd55cf92-BI_DAILY&utm_medium=email&utm_term=0_4027db42dc-86bd55cf92-319686089.

²Ligji Nr. 02/L-037 Për përdorimin e gjuhëve (27 qershor 2006), Neni 2.1.

³<http://kuvendikosoves.org/?cid=3,1> or <http://www.kryeministri-ks.net/?page=3,1> or <http://president-ks.gov.net/?page=3,1>

⁴<https://koha.net/?id=27&l=68256>; <http://www.rtklive.com/rtk2/?id=2&r=2618>.

⁵<https://koha.net/?id=27&l=68288>.

Në ndërkohë, deputetja Haxhiu, ka sqaruar vendimin e saj që sillej rreth çështjes së logos së Kuvendit të vendosur në një propozim dërguar Komisionit që ishte shkruar në alfabetin cirilik, për ç'gjë ajo bëri me dije se nuk ishte logo e njëjtë që Kuvendi i Kosovës përdor në dokumentet dhe korrespondencat zyrtare. Për këtë arsye, Komisioni i ka referuar çështjen administratës së Kuvendit duke kërkuar sqarime për këtë çështje.⁶ Haxhiu ka thënë se nuk do të kërkojë falje sepse vendimi nuk është bërë nga ajo personalisht, por është bërë nga Komisioni të cilin ajo udhëheq në Kuvend. Për më tepër, ajo ka shtuar se reagimi i Ministrit Jevtiq është pjesë e strategjisë së Listës Serbe për të shkatërruar shtetin e Kosovës, nën direktivat e Beogradit.⁷

Ndarja e tanishme politike është një kthim i padëshiruar tek politika kundërshtuese shqiptaro-serbe e parë gjatë dimrit të kaluar, që në fakt ishte qetësuar pas dorëheqjes së ish-ministrit për Komunitete dhe Kthim Aleksandar Jablanović dhe pozicioni i Listës Serbe në qeverinë e Kosovës ishte stabilizuar. Situata e krijuar mund të politizojë atë që në fakt është një çështje e dykuptimisë apo paqartësisë ligjore në disa nga dispozitat e Ligjit mbi përdorimin e gjuhëve, dhe në veçanti tek çështja se cili alfabet do të duhet të përdoret në korrespondencën zyrtare brenda institucioneve të qeverisë. Gjatë periudhës së hartimit të ligjit, vitet 2005-06, kjo çështje u la e hapur - në pritje të një diskutimi të plotë në mes të përfaqësuesve të komunitetit shqiptar dhe atij serb për të gjetur një ekuilibër mes nevojës për komunikim të ndërsjellë në mes komuniteteve të ndryshme në Kosovë dhe të drejtës për shprehur lirshëm identitetin përkatës kombëtar nëpërmjet përdorimit të gjuhës dhe alfabetit pa provokuar komunitetet e tjera. Për fat të keq, debati rreth kësaj çështjeje nuk ka ndodhur deri më tani - dhjetë vjet pas miratimit të ligjit. Si rezultat i kësaj, çështja e alfabetit është ende e hapur, që rezulton në faktin që në disa dokumente zyrtare përdoret alfabeti cirilik (siç është rasti me pasaportat dhe kartat e identitetit të Republikës së Kosovës) ndërsa në shumicën e faqeve zyrtare të internetit të qeverisë dhe në korrespondencat e tjera përdoret alfabeti latin.

Rasti i fundit e bën mjaft të qartë se përfaqësuesit politik dhe institucionet e Kosovës duhet të marrin masat e duhura për të qartësuar se cili/cilat alfabet/e në gjuhën serbe duhet të jetë/jenë në përdorim zyrtar dhe kur.

Më gjerësisht, incidenti edhe një herë sjell vëmendjen tonë në zbatimin e dobët të Ligjit për përdorimin e gjuhëve. Në një raport të kohëve të fundit, në bazë të hulumtimeve të zbatuar nga ECMI Kosova, Zyra e Komisionarit për Gjuhët ka identifikuar një numër sfidash në lidhje me zbatimin dhe përputhshmërinë me Ligjin për përdorimin e gjuhëve në institucionet e nivelit lokal dhe qendror të Republikës së Kosovës. Më e rëndësishmja nga këto sfida është mungesa e profesionistëve gjuhësorë dhe kapaciteteve infrastrukturore për ofrimin e shërbimeve të brendshme gjuhësore në institucionet publike (çështje të ndërlidhura me buxhet dhe trajnime), duke rritur në këtë mënyrë shkallën e një-gjuhësisë të zyrtarëve që punojnë në institucionet publike, ndërgjegjësimin e kufizuar dhe të kuptuarit e kuadrit ekzistues ligjor, dhe përdorimi i gjuhës si një simbol për ndarje apo hendeqe politike-etnike.⁸

⁶<https://koha.net/?id=27&l=68288>

⁷<https://koha.net/?id=27&l=68288>.

⁸ Zyra e Komisionarit për Gjuhët /Zyra e Kryeministrit, në bashkëpunim me ECMI Kosovën dhe Programin për Zhvillim të Kombe të Bashkuara – UNDP-në. *Monitorimi dhe vlerësimi i të drejtave gjuhësore në Kosovë* (mars 2015).

Themelimi i Zyrës së Komisionarit për Gjuhët, në prill të vitit 2012, është një hap në drejtim të duhur drejt zbatimit të kënaqshëm të dispozitave ligjore. Sidoqoftë, sigurisht që ka nevojë për më shumë, veçanërisht për sa i përket rritjes së fondeve për të trajtuar më mirë disa mangësi buxhetore dhe për të ofruar kapacitet dhe/apo profesionistë që do të ofronin shërbime të brendshme gjuhësore. Veç kësaj, do të duhet të mbahet një diskutim në një mënyrë konstruktive dhe jo të politizuar në mënyrë që të vendoset një standard për korrespondenca zyrtare dhe përdorim të gjuhëve zyrtare.

Përtej kësaj çështjeje, në qoftë se Kosova bën përpjekje të zbatojë Ligjin për përdorimin e gjuhëve zyrtare, nevoja për mësimin e gjuhëve shqipe dhe serbe që nga fazat më të hershme në sistemin arsimor do të duhej të diskutoheshin në mënyrë serioze dhe të konsideroheshin nga përfaqësuesit e të dy komuniteteve, shqiptarë dhe serbë në Kuvendin e Kosovës.

Për lexim të mëtejshme mbi çështjet gjuhësore, ju lutem referojuni faqes zyrtare të internetit të ECMI Kosovës, e cila përmban një bazë të pasur të të dhënave, të raporteve dhe studimeve të ndryshme mbi çështjet gjuhësore në Republikën e Kosovës.

*Nëpërmjet **Kosovo Communities Issues Monitor**, (Monitoruesit të Çështjeve të Komuniteteve të Kosovës) ECMI Kosova monitoron, analizon dhe ofron rekomandime mbi zhvillimet dhe shqetësimet që ndërlidhen me pozicionin e komuniteteve pakicë në Kosovë, brenda kornizës së legjislacionit ndërkombëtar dhe vendor mbi të drejtat e pakicave. Analizat e paraqitura në Monitorues janë të mbështetura në monitorimin e rregullt dhe të ngushtë të medieve dhe intervistave me palë përkatëse të interesit. Në ndërkohë që ECMI Kosova përpiqet në çdo kohë që të sigurojë informacion të saktë dhe të nuancuar për të prezantuar pikëpamjet dhe perceptimet e të gjitha palëve, objektivi apo synimi i Monitoruesit nuk është që të sigurojë mbulim gazetaresk apo paraqitje faktike, por të ofrojë një element shtesë analitikë të debatit, duke reflektuar përvojën afatgjate të ECMI Kosovës mbi çështjet që kanë të bëjnë me komunitete pakicë në Republikën e Kosovës dhe kuadrin ekzistues ligjor të Kosovës dhe atë ndërkombëtar.*

Raporte dhe analiza politike të tjera të realizuara nga ECMI Kosova:[Hyn në fuqi pakoja e ligjeve për të drejtat e njeriut](#)**26 korrik, 2015**[Mbi trendin shqetësues të incidenteve të drejtuara ndaj komitetit serb në regionin e Pejës dhe Klinës](#)**19 korrik, 2015**[Vivovdani: Mungesa e lajmeve është lajm i mirë](#)**2 korrik, 2015**[Rreth incidenteve të fundit në Klinë dhe procesin e ngadalshëm të kthimit](#)**21 maj, 2015**[Dita memoriale e goranëve më 6 maj: Një mundësi e humbur për institucionet e Kosovës](#)**14 maj, 2015**[Me rastin e incidentit të fundit në Pasjan](#)**10 maj, 2015**[Buxhetet e komunave veriore të Kosovës: Marrëveshje më në fund](#)**7 maj, 2015**[Incidentet dhe tensionet në Mitrovicë: Nevoja për raportim objektiv dhe forcim të sundimit të ligjit](#)**21 prill, 2015**[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Çfarë është e \(pa\)mundur në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës?](#)**16 prill, 2015**[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Një klub ekskluziv I bazuar në përkatësinë etnike?](#)**31 mars, 2015**[Komunitetet pakicë jo-serbe të neglizhuar në marrëveshjet teknike në mes të Kosovës dhe Serbisë](#)**10 mars, 2015**[Bashkësia/Asociacioni i komunave me shumicë serbe: Shumë spekulime, pak marrëveshje faktike dhe mos-zbatim](#)**22 shkurt, 2015**[Një sistem juridik dhe gjyqësor i unifikuar në Kosovë?](#)**15 shkurt, 2015**[Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)**8 shkurt, 2015**[Farkimi i një mjedisi pune në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)**19 janar, 2015****Rreth ECMI Kosovës**

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumetnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e aktorëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëpunuar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.